



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

14.04.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINE SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DOREZIM - PUNË MARRË - RECEIVED			
Njësia org. Org. Unit	Numri Noj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
10	016	16776	3

Datë: 14.04.2025

Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë në Komunën e Suharekës

Bazuar në rregulloren e Ministrisë së Financave me Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve shpall:

THIRRJE PUBLIKE 2026

Për mbështetje financiare publike të OJQ-ve në projektet me aktivitete kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Suharekës

Drejtoria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgatës u bënë thirrje organizatave të regjistruara si OJQ në Republikën e Kosovës, programi i të cilave është i fokusuar në Komunën e Suharekës, që të aplikojnë për mbështetje financiare me projekte kulturore, rinore dhe sportive.

Të drejtë aplikimi me projekt –propozime në këtë thirrje kanë OJQ-të që dëshmojnë se veprojnë në Komunën e Suharekës dhe realizojnë aktivitetet e tyre në Komunën e Suharekës

Në fushën e Kulturës:

LOT I

U dedikohet organizatave kulturore që veprojnë në Komunën e Suharekës dhe që operojnë gjatë tërë vitit dhe kanë aktivitete kulturore të nivelit **kombëtarë dhe mbarëkombëtarë**, të cilat kontribuojnë në mënyrë të dëshmuar në zhvillimin kulturor, ekonomik, shoqëror, gjithëpërfshirje dhe në barazi gjinore në Komunën e Suharekës. Organizatat kulturore që posedojnë struktura të qarta qeverisëse, si dhe strategji afatshkurta dhe afatmesme organizative dhe programore.

Aktivitete që kontribuojnë në shumëllojshmëri artistike dhe aktivitetet që begatojnë jetën e komunitet në fushën e kulturës, me fokus të veçantë ato që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen dhe barazi gjinore.

- Përkrahja e programit vjetor të organizatave
- Promovimi kulturor i Komunës së Suharekës
- Krijimi i produkteve të reja kulturore
- Ofrimi i programeve edukative për publikun e Komunës së Suharekës
- Organizimi i festivaleve, shfaqjeve teatrale film, film dokumentar, koncerteve, ekzpozita, ngjarjeve historike e të tjera brenda territorit të Komunës së Suharekës.

LOT II

U dedikohet organizatave kulturore që zhvillojnë aktivitete të ndryshme kulturore dhe festive me karakter afatgjatë në nivelin komunal.

Aktivitete që kanë për qëllim pasurimin e kalendarit vjetor, kulturor që kontribuojnë në shumëllojshmërinë artistike dhe aktivitete që begatojnë jetën e komunitetit në fushën e kulturës, me fokus të veçantë ato që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me gjithpërfshirje dhe barazi gjinore.

Synimet specifike në LOT II

- Organizmi i festivaleve, koncerteve, ekspozita personale të artistëve kombëtar dhe ndërkombëtar brenda territorit të Komunës së Suharekës
- **Muzikë:** kompozim i veprës së re, audio incizim, koncert, fuqizim i muzikantëve të rinj
- **Art vizual - Figurativ:** krijimi i vepRës së re, fuqizimi i artistëve të rinj, ekspozita të organizuara në hapsira publike.
- Manifestime:** Shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shënimi i datave të tjera me rëndësi në Komunën e Suharekës.
- Shoqëritë kulturore-artistike,** mbështetje e aktiviteteve në promovimin e krijtarisë lokale artistike, dhe shënimi i datave historike kombëtare dhe datave tjera me rëndësi për Komunën e Suharekës.
- Kinematografi:** film dokumentar, film i shkurtër, fuqizim i kinematografëve të rinj në ruajtjen e traditave lokale dhe trashëgimisë kulturore të Komunës së Suharekës.
- Mbështetja e aktiviteteve kulturore të personave me nevoja të veçanta.
- Botimi dhe promovimi i librave

Në fushën e Rinisë

Synimet specifike:

- Mbështetja e aktiviteteve rinore, promovimi i vullnetarizimit, integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, mbështetja e ideve - projekteve si dhe promovimi i talenteve të rinj.
- Edukimi jo formal: trajnime, punëtori, debate, hulumtime për të rinjtë që ndikojnë drejtpërdrejtë në mxitjen e aktiviteteve rinore dhe luftimin e dukurive negative tek të rinjtë.
- Mbështetja e aktiviteteve rinore për personat me nevoja të veçanta.
- Organizimi për shënimin e datave kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter rinor.
- Mbështetje të personave me projekte inovative teknologjike

Në fushën e Sportit :

LOT I

U dedikohet subjekteve apo klubeve të Komunës së Suharekës që operojë gjatë tërë vitit dhe që posedojnë struktura të qarta udhëheqëse dhe strategji organizative dhe programore.

- Të kanë në gjirin e tyre trajner të licencuar (të dëshmohet);
- Të kanë çmime të fituar (të dëshmohet);
- Të jenë pjesë e superligës;
- Organizimi i aktiviteteve sportive –turnireve
- Aktivitetet rekreative dhe sportive për të rinj;
- Projekte që promovojnë jetesën e shëndetshme dhe aktivitetin fizik;
- Aktivitetet që nxisin përfshirjen e të rinjve në sport dhe në vullnetarizëm;
- Programet për zhvillimin e aftësive jetësore përmes sportit;
- Aktivitetet që promovojnë barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në sport;
- Nisma që forcojnë bashkëpunimin ndërmjet klubeve sportive, shkollave dhe komunitetit;
- Projekt që promovojnë sportin amator dhe rekreativ.

LOT II.

- Zhvillimi i sportit në Komunën e Suharekës
- Masovizimi i sportit për të rinjët, avancimi i aktiviteteve në klubet sportive të femrave, integrimi i personave me nevoja të veqanta në aktivitete dhe gara sportive
- Promovimi i talentëve të rinjë
- Projekte të ndryshme me grup-mosha të ndyshme
- Edukimi i të rinjëve përmes sportit (projekte edukative për grup mosha të reja)
- Aktiviteteve rekreative dhe sportive për nderë të datave të veqanta

2.Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision prej 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësimin, sipas rregullores MF-NR04/2017 mbikritret dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

3.Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

- Formulari i Aplikacionit për projekt
- Formulari për buxhet/ programin e shtypur
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë
- Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit
- Dokumenti identifikues i personit të autorizuar
- Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së
- Çertifikata e numrit fiskal të OJQ-së

- Letërkonfirmimi i OJQ-së(jo me i vjetër se 1 muaj)
 - Vërtetimi i ATK-së, (jo më të vjetër se 3 muaj)
 - Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
 - Çertifikatën që nuk jeni nën hetime për personin e autorizuar të OJQ-së.
- (Të gjitha dokumentet e kompletuara të jenë të shtypura në dy kopje)

4. Formulari për aplikim mund të nxerret në web-faqe të Komunës dhe mund të dorëzohen duke filluar nga data 14.04.2026 deri me 05.05.2026. Aplikacionet pas afatit nuk pranohen.

5. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Kulturës:

Shuma e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e kulturës për projektet që kanë përmbajtje serioze është:

LOT I – 1.000.00€ deri në 7,000.00 €

LOT II – 2.000.00€ deri në 30,000.00 €

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Rinisë:

Shuma e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e rinisë për projektet që kanë përmbajtje serioze është:

LOT I – 10,000.00 €

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për ojq-të nga lëmia e Sportit:

Shuma e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e sportit për projektet që kanë përmbajtje serioze është:

LOT I – 2.000.00€ deri në 40,000.00 €

LOT II –1.000.00 € deri në 15,000.00 €

Kushtet e përgjithëshme për aplikim:

1. Të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të e regjistruara në regjistrin e orgnizatave Jo-qeveritare në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Suharekës.
2. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në njërin nga fushat e aplikimit .
3. OJQ-të po ashtu të kenë të kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunes së Suharekës- Drejtorisë për Kulturë, Rini ,Sport dhe Mërgatë.
4. Propozimet do të dorëzohen vetëm me formularët e paraparë të cilët janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare Komuna e Suharekës.
5. Dokumentete kompletuara duhet të dërgohen te zyra pritëse NR.1
6. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i komenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara.
7. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të thirrjes publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Vërejtje:

Komuna e Suharekës-Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë këtë vit do të përkrah ato projekte që janë serioze dhe që kanë programet në interes të promovimit të kulturës, sportit dhe rinisë për qytetin dhe qytetarët të Komunes së Suharekës.
Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë: inventari, qiraja për zyre, komunalit si dhe nuk përkrahen projektet që kenë ndikim politik, religjioz etj.

Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë nuk është e detyruar të ndajë të gjithë buxhetin e paraqitur të planifikuar në projekt –aplikacion.

Buxheti do të ndahet për projektet kualitative të vlerësuara nga komisioni

OJQ-të që nuk e kanë sjell raportin përfundimtar për vitin fiskal 2025 nuk do të përkrahen.

Me respekt,

Drejtorë e DKRSM.

Dënjete Kabashi

